

FJALA E DEPUTETES JORIDA TABAKU

E PREMTE 28 TETOR 2022

Edhe unë do t'i ruaj komentet për në fund, por kam pyetje për tri elemente që më kanë shqetësuar gjatë leximit të raportit. Ju thoni se nga 130 auditime, 104 kanë rezultuar negative, ose me probleme. Si mundet që të ketë një përshtypje pozitive dhe të jepet një vlerësim pozitiv për zbatimin e buxhetit faktik kur në 104 auditime nga 130 dalin me probleme me mangësi të vogla, të mesme, të mëdha. Ky është raporti që ju keni paraqitur. Unë e kam ngritur që kur është diskutuar në buxhetin e vitit të kaluar, por njëkohësisht edhe në diskutimin për buxhetin faktik çështjen e rindërtimit. Në fakt, më është hedhur i gjithë komisioni kundër dhe më kanë thënë se po abuzoja, ndërkohë që në këtë raport, në faqen 15 të tij, konfirmohet pikërisht ajo që kam thënë unë.

Nga auditimi është konstatuar se vlera e fondeve prej 30 miliardë lekësh të shpërndara me VKM, deri në fund të vitit 2021 është mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit të shtetit 2020 dhe 2021, të marrë së bashku për fondet e rindërtimit. Kjo do të thotë se janë planifikuar në shumën 67 miliardë lekë dhe janë harxhuar 97 miliardë lekë që do të thotë se qeveria shqiptare ka shpenzuar pa i pasur të planifikuara në ligjin e buxhetit. Kështu do ta lexojmë këtë? Unë kam lexuar edhe gjetjet e raportit special që ju keni bërë për rindërtimin, një raport i tërë i veçantë për shkeljet e rindërtimit, por njëkohësisht edhe VKM-në që qeveria miratoi këtë vit me fondin shtesë për rindërtimin që, në fakt do të thotë se qeveria nuk i ka pasur fondet në dispozicion dhe janë përdorur fonde, të cilat nuk kanë qenë të miratuara në buxhetin e shtetit.

Çështja e dytë që dua t'ju pyes lidhet me faturat e arbitrazhit. Në raportin e vitit të kaluar të KLSH-së dhe në të gjitha komunikimet që unë kam me Avokaturën e Shtetit kam pasur të paktën mbi 10 komunikime me shkresat e Avokaturës së Shtetit, totali vlera në euro për çështje që shteti shqiptar ka është 388 milionë euro. Kjo konfirmohet edhe nga raporti i juaj i vitit të kaluar. Është po kjo shifër, dhe unë për këtë e pyeta Avokaturën e Shtetit, si janë materializuar dhe ndarë në çështje 388 milionë euro që janë në proces, ndërkohë që në raportin e këtij viti vlera është 155 dhe këto çështje nuk janë më. Unë i kam të konfirmuara me shkresa, OSHEE-ja ka një gjyq në Arbitrazh, është çështja me Beketin, gjithashtu , janë dy çështje me Alb Petroleum, dhe Koprin. Pra, që nga viti 2017 e në vijim janë të gjitha çështjet cilat Avokatura e Shtetit m'i ka konfirmuar si detyrime, ndërkohë në raportin e kaluar ishin, por në këtë raport nuk shfaqen te buxheti faktik.

Çështja e tretë për të cilën unë dua të interesohem janë detyrime në sektorin e energjisë, në fakt, detyrimet të ndërsjella ndërmjet ndërmarrjeve në sektorin e energjisë janë një problemi i jashtëzakonshëm i reflektuar edhe në materialin tuaj. Për të nxjerrë këtë shifër që kam këtu për detyrimet e ndërsjella më është dashur që të lexoj jo vetëm raportin e KLSH-së, por edhe të OST-së, OSHE-së, AKUM-it të Ministrisë së Financave për të dalë në shifrën që unë kam këtu, por që pres të ma konfirmoni ju. Sa janë borxhet e ndërmarrjeve të sektorit energjetik të ndërsjella me njëra-tjetrën dhe njëkohësisht si është situata me ujësjellës-kanalizimet? Nga raporti që ju keni paraqitur ujësjellës-kanalizimet janë një nga sektorët që ka 190 milionë euro borxhe detyrime të akumuluar ku vetëm Durrësi ka 57 milionë euro.

Së fundi, në lidhje me risqet e buxhetit të shtetit, pjesën tjetër do ta bëj si pjesë të komenteve, kur kemi diskutuar buxhetin në vitin 2021-2022 unë kam insistuar me stafin e Ministrisë së Financave të di risqet që ka buxheti i shtetit. Për asnjëherë stafi i Ministrisë së Financave, dhe këtu i referohem diskutimit që patëm me ministren kur u miratua buxheti i vitit 2022, nuk e ka përmendur riskun e PPP-ve si një risk real, ndërkohë që këtu përmendet risku i PPP-ve, risku i cili është materializuar, sepse ju thoni 2,5% e pagesave janë bërë për PPP-të e viteve të kaluara, pra për detyrime të prapambetura të kontratave të PPP-ve. Risku i normave të interesit, dhe sidomos i vitit të kaluar, që është një risk i shtuar, si materializohet në buxhetin e vitit 2021? Së fundi nga pikëpamja e zbatimit të kontratave koncesionare, unë shikoj në të gjitha sugjerimet që ju keni dhënë për kontratat koncesionare, të cilat më duken të përsëritura. Jam përpjekur që t'i mbaj shënim, në fakt, ngaqë materiali ishte voluminoz.

Kontrolli i check-up-it, sterilizimi, setet laboratorike kanë të njëjtat gjetje me vitin e kaluar. Kontrollë të pakryera për sete laboratorike sterilizime, të cilat kanë ndodhur me një numër më të vogël me një kosto më të lartë, por njëkohësisht e njëjta gjë është edhe për hemodializën. Të gjitha gjetjet për të tri koncesionet e shëndetësisë janë njësoj si viti i kaluar, të tri kontratat janë në shkelje. Si kryetar i KLSH-së pse i gjykoni që është e nevojshme që ne thjeshtë të vazhdojmë t'i konstatojmë që vazhdojnë të paguhen me shkelje pa u marrë asnjë masë? Pra, kontrata koncesionare që ende vazhdojnë dhe paguhen nga buxheti i shtetit në mënyrë të përsëritur për të njëjtat shkelje, por në një numër më të vogël kontrollesh për më pak sete laboratorike po njëkohësisht e njëjta gjë edhe me kontratën e tretë? Faleminderit!